



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

D E K R E T

“PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 38/2019 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE””**

Në mbështetje të neneve 85, pika 1 dhe 93, të Kushtetutës,

D e k r e t o j

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr.38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””, me qëllim rishikimin e nenit 3 dhe 4, sipas arsytimit bashkëlidhur.

Nr. Dekreti 11227

Tiranë, më 15.07.2019

PRESIDENTI I REPUBLIKËS



ILIR META

Arsyet e kthimit të ligjit nr. 38/2019

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””

Të nderuar deputetë,

Kuvendi i Shqipërisë, në seancën plenare të datës 20 qershor 2019, ka miratuar ndër të tjera dhe ligjin nr. 38/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Me shkresën nr. 2596 prot., datë 26.06.2019 të Kuvendit, ky ligj është përcjellë Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje, praktikë kjo e administruar me nr. 2003 prot., datë 26.06.2019.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare mbi propozimin, shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji rezulton se ligji i miratuar në Kuvend “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””, ka si qëllim kryesor që nëpërmjet ndryshimeve të propozuara sipas nenit 1 të tij, ai synon të nxisë dhe fuqizojë bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë, si dhe të mbrojë interesat e shtetit brenda fushave të përgjegjësisë.

Gjatë zbatimit të ligjit nr.139/2015, është evidentuar nevoja për implementimin e plotë të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve, si edhe nevoja për krijimin e mekanizmave ligjorë në nivel vendor sa i takon zhvillimit të raporteve me diasporën.

Pikërisht realizimi i këtij qëllimi është parashikuar me miratimin e nenit 1 dhe nenit 2 të ligjit nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Një tjetër ndryshim i propozuar me ligjin nr. 38/2019, është edhe ndarja e kompetencave të Këshillit Bashkiak në rastet e tjetërsimit të pronës me të drejtën për dhënien në përdorim. Njëkohësisht me këto ndryshime është zgjeruar koncepti i tjetërsimit të pronës publike duke shtuar brenda tij dhe të drejtën e zhvillimit të pronës nga organet e pushtetit vendor.

Konkretisht nëpërmjet ligjit nr.38/2019, synohet të ndryshohen nenet 54 dhe 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që parashikojnë detyrat dhe kompetencat e Këshillave Bashkiakë, mënyrën e vendimarrjes dhe kuorumin e nevojshëm për çdo lloj vendimmarrje të këtyre organeve përfshi këtu dhe vendimmarrjet për tjetërsimin e pronës publike.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare, rezulton se ndryshimet e propozuara në nenet 54-55 të ligjit nr. 139/2015, nuk janë propozuar nga Këshilli i Ministrave, por ato janë propozime të paraqitura nga relatori i projektligjit në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë dhe të mbështetura nga anëtarët e Komisionit.

Ky projektligj është shqyrtuar në dy komisione në Kuvendin e Shqipërisë, konkretisht në Komisionin për Politikën e Jashtme që kanë lidhje me ndërhyrjet të realizuara me nenin 1 të ligjit nr. 38/2019, si dhe në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut përsa i takon pjesës tjetër të ligjit të miratuar.

Presidenti i Republikës shqyrtoi ligjin nr. 38/2019, duke ju referuar përmbajtjes së aktit të dërguar për dekretim dhe shpallje, praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim dhe legjislacionit ekzistues.

Presidenti i Republikës vlerësoi përputhshmërinë e këtij ligji, duke bërë një analizë të përmbajtjes së aktit të miratuar në raport me interesin publik.

Në përfundim të këtij shqyrtimi, Presidenti i Republikës vlerëson të evidentojë se dispozitat e nenit 1 të ligjit nr. 38/2019, janë një hap shumë pozitiv i Kuvendit të Shqipërisë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve.

Nëpërmjet dispozitave të nenit 1 të ligjit nr. 38/2019, shteti shqiptar bën një hap të rëndësishëm drejt procesit të implementimit të reformës ligjore dhe institucionale për ndërtimin e marrëdhënieve të natyrshme të atdheut me shtetasit e vet, nëpërmjet dhënies së shërbimeve për diasporën dhe migracionin.

Nisur nga këto qëllime shumë positive Presidenti i Republikës, shpreh dakordësinë e tij për realizimin e shtesave në ligjin ekzistues nr. 139/2015, që bëhen të mundura nëpërmjet dispozitave të nenit 1 të ligjit nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Nga ana tjetër, referuar përmbajtjes së nenit 3 dhe nenit 4 të ligjit nr. 38/2019, objekt i këtij shqyrtimi Presidenti i Republikës, ka arritur në përfundimin se propozimi i relatorit për realizimin e ndryshimeve ligjore në nenin 54-55 të ligjit nr. 139/2015, cenon procesin vendimmarrës së Këshillave Bashkiake në lidhje me tjetërsimin e pronave të tyre. Këto ndryshime janë të pajustificuara, pasi mënyra e re që propozohet për kuorumin e nevojshëm në vendimmarrjet e Këshillave Bashkiake nuk garanton mbrojtjen e interesit publik në procedurat e tjetërsimit të aseteve publike në pronësi të pushtetit vendor.

Bazuar mbi këtë arsyetim, të shpjeguar si më poshtë vijon, në bindje të Kushtetutës dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të saj, Presidenti i Republikës, vlerëson se ligj nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””, i duhet kthyer Kuvendit, me qëllim rishikimin e neneve 3 dhe 4 të këtij ligji.

Konkretisht;

Në nenin 54/e të ligjit aktual nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, parashikohet shprehimisht se:

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

Ndërkohë që në nenin 55, pikat, 3 dhe 4, parashikohet se:

Neni 55

Votimi

3. Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji.

4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën “e”, të nenit 54, të këtij ligji.

Pra siç duket qartë, sipas dispozitave të mësipërme ligjore, është parashikuar shprehimisht në ligj se Këshilli Bashkiak, për të gjitha vendimet ku do të trajtohen vendimmarrje të tjetërsimit ose dhënies në përdorim të pronave në favor të të tretëve, këto vendime duhet të merren dhe të miratohen me një shumicë të cilësuar të votave të këtij organi me jo më pak se 3/5 (tre të pestat) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.

Nëpërmjet këtyre dispozitave të ligjit nr. 139/2015, ligjvënësi ka parashikuar se vendimmarrja për tjetërsimin e pronës publike, që është në pronësi të pushtetit vendor, konsiderohet me shumë rëndësi dhe jetike për autonominë e pushtetit vendor dhe vendimmarrja mbi këto çështje duhet të realizohet nëpërmjet një shumice të cilësuar votash, duke diktuar kështu një mekanizëm monitorues dhe shprehës të vullnetit të qytetarëve mbi veprimtarinë e pushtetit vendor.

Ligjvënësi ka qenë i kujdesshëm që për këto çështje, kontrolli dhe balanca brenda funksionimit të vet organeve të qeverisjes së pushtetit vendor të parashikohet me ligj dhe për këtë, funksionimi dhe zbatimi i ligjit me objektivitet do të rrisë transparencën në vendimmarrje të kësaj natyre.

Por ndryshe nga kjo frymë që paraqet ligji ekzistues, rezulton se gjatë punës në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratën Publikë dhe të Drejtat e Njeriut, është bërë një propozim i cili e prish këtë regjim të vendosur nga ligji ekzistues. Komisioni ka marrë në shqyrtim dhe ka pranuar propozimin e paraqitur nga relatori për ndërhyrje në dispozitat e mësipërme që trajtojnë kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe vendimmarrjen e tij, në kuadër të ushtrimit të të drejtës së pronësisë të bashkive.

Konkretisht sipas dispozitave të nenit 3 dhe 4 të ligjit nr. 38/2019, të miratuar, objekt i këtij shqyrtimi, në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore”, janë miratuar këto ndryshime:

Neni 3

Në nenin 54 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) miraton tjetërsimin e pronave të tretëve”.

2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “e/1” me këtë përmbajtje:

“e/1) miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private”.

Neni 4

Në nenin 55, pika 3, pas referencës në shkronjën “d” shtohet referenca në shkronjën “e/1”.

Siç rezulton qartësisht nga kjo ndërhyrje që propozohet të realizohet, në ligjin nr. 139/2015, ky ndryshim në ligj në thelb krijon një kompetencë të re për Këshillat Bashkiak, që është e drejta e këtyre të fundit për të hyrë në marrëdhënie juridike me persona të tretë për zhvillimin e pronës publike. Kjo kompetencë nuk ka qenë parashikuar më parë në ligj.

Sipas raportit të Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, kjo ndërhyrje bëhet e nevojshme për shkak të dinamikës së zhvillimit infrastrukturor dhe urban të qyteteve, veçanërisht në dhjetëvjeçarin e fundit.

Parashikimi i një kompetence të re për Këshillat Bashkiak, është në vlerësim të Kuvendit të Shqipërisë, i cili nëpërmjet këtij ndryshimi ligjor synon të delegojë më shumë pushtet vendimmarrës në drejtim të organeve të qeverisjes vendore, por e rëndësishme është që kjo kompetencë e re të ushtrohet bazuar në parashikime të qarta ligjore që rregullojnë mënyrën se si kjo kompetencë do të ushtrohet, në mënyrë që të respektohen parimet kushtetuese të nismës së lirë dhe konkurrencës.

Presidenti i Republikës, konstaton se Kuvendi i Shqipërisë, me ndryshimet që ka vendosur të realizojë nëpërmjet nenit 3 dhe 4 të ligjit nr. 38/2019, po krijon një kompetencë të re për autoritetet vendore, por nuk ka parashikuar asnjë dispozitë mbi mënyrën ligjore se si këto autoritete (Këshillat Bashkiakë) do të formojnë vullnetin e tyre për të përzgjedhur subjektin me të cilin do të hyjnë në marrëdhënie për të zhvilluar pasuritë e paluajtshme në pronësi të tyre.

Kjo gjendje paqartësie, krijon shteg për abuzim dhe mundësi që në praktikë kjo kompetencë e re të keqpërdoret me pasoja të pariparushme për pronën publike dhe interesin publik.

Gjithashtu, e drejta për zhvillim e pronës në pronësi të pushtetit lokal është drejtpëdrejtë një mënyrë tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme.

Pasuria e paluajtshme pronë publike në pronësi të organeve të qeverisjes vendore kur vendoset në dispozicion të zhvillimit të projekteve të përbashkëta me pronarë apo subjekte të tjerë privatë, humbet funksionin fillestar të saj, pasi përfshirja në projekte të përbashkëta zhvillimi bën të mundur krijimin e regjimeve të reja të drejtave të pronësisë apo bashkëpronësisë dhe mënyrës së përdorimit të pasurisë së re që do të përfitohet nga ky zhvillim.

Në këtë mënyrë përfshirja e pasurisë pronë shtetërore apo publike në një marrëdhënie zhvillimi me persona të tretë përbën në thelb tjetërsim të saj, pasi nga ky proces ndryshohet marrëdhënia e drejtpëdrejtë e pronarit (Këshillit Bashkiak) me pronën e vënë në dispozicion, ashtu sikundër ndryshojnë dhe raportet e pronësisë mbi pasurinë, për shkak se ajo transformohet në një pasuri tjetër të re ku marrin pjesë edhe persona të tjerë me të drejta pronësie të lidhura apo të shkruara ndërmjet tyre.

Në këtë mënyrë arsyetimi i bërë nga Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë se e drejta e tjetërsimit të pronës nuk përfshin të drejtën për dhënie për zhvillim të pronës të tretëve, nuk qëndron dhe është tërësisht i pabazuar.

Në këto kushte edhe ndryshimet e realizuara në nenin 4 të ligjit nr. 38/2019, nëpërmjet të cilave bëhet e mundur që vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e dhënies për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private, të përfshihen në ato vendime për të cilat nevojitet një kuorum vendimmarrës i thjeshtë me shumicën e anëtarëve të Këshillit, siç parashikon neni 55, pika 3, e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është një vlerësim i gabuar dhe aspak objektiv.

Nëse Kuvendi i Shqipërisë, vlerëson ti japë autoriteteve vendore një kompetencë të re ligjore, që përfshin të drejtën për të bashkëpunuar me subjekte apo personave privatë për zhvillimin e pronës në pronësi të autoriteteve vendore, atëherë kjo e drejtë për të zhvilluar pronën, e cila përbën një nga mënyrat e tjetërsimit të pronës, duhet të përfshihet në ato raste ku vendimi për këtë çështje duhet të merret me një shumicë të


cilësuar në Këshillin Bashkiak, pra me 3/5 e të gjithë anëtarëve të këshillit, siç parashikon sot neni 54, germa “e” dhe pika 3 e nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në nenin 54 dhe 55 të ligjit nr. 139/2015, çenojnë kuorumin e nevojshëm të vendimmarrjes së Këshillave Bashkiake për çështje të tjetërsimit dhe zhvillimit të pronës në pronësi të pushtetit vendor, janë të pajustificuara dhe nuk garantojnë mbrojtjen e interesit publik.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve që realizohen nëpërmjet nenit 3 dhe 4 të ligjit nr. 38/2019, ulet niveli vendimmarrës i kontrollit të organit kolegjal të Këshillit Bashkiak ndaj propozimeve dhe veprimtarisë të organit ekzekutiv të Kryetarit të Bashkisë, ç’ka krijon mundësi që zhvillimi i pronave të shtetit në bashkëpunim me persona të tretë të realizohet përkundrejt përfitimeve për shtetin që nuk përkojnë me kërkesat e ligjit, me realitetin dhe me kushtet që ofron tregu.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Për arsyet e parashtruara më sipër, në bindje të Kushtetutës dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1, të nenit 85 të saj, kam vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””, me qëllimin që Kuvendi i Shqipërisë të rishikojë nenet 3 dhe 4 të këtij ligji.



Singerisht,
Ilir Meta